



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Buletini

Publikim
dymujor
Viti VIII
Nr.50
Shtator - Tetor
2011

Takimi i Këshillit të Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës

25 tetor 2011 - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takimin e Këshillit të Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës me përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Agjencionit për Ushqim dhe Veterinë dhe ICITAP-t. Me qëllim të zbatimit sa më të mirë në praktikë të ligjeve që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e autoriteteve lokale u organizua ky takim, ku për diskutim kishte disa pika ndër to, Ligji për Ndërmarrje Publike, Inspeksioni sanitar dhe fito-sanitar dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVS).



FOTOLAJM : Nga fjala e kryetarit të AKK-së mbajtur në Konferencën e Dytë Vjetore Ndërkombëtare për Qeverisjen Lokale

AKK-ja kërkon plotësim-ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal

Me anë të një kërkesë nënshkruar nga kryetari z.Bajrush Xhemaili dhe drejtuari z.Bedri Hamza – Ministër i Ministrisë së Financave dhe z.Slobodan Petrovic –Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), kërkon fillimin e plotësim-ndryshimit të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049.

A po shkatërrohen pyjet?

Në seminarin e organizuar për të diskutuar për rolin e qeverisë qendrore dhe lokale për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve në Kosovë, Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së tha se “se prej kur është bërë delegimi i kompetencave është ndaluar në masë të madhe edhe prerja e pyjeve në mënyrë ilegale, mirëpo numri i punëtorëve në sektorin pyjor nuk është i mjaftueshëm për kryerjen me sukses të përgjegjësisë të deleguara”.

Mbahen pesë punëtori rajonale për shërbime sociale

AKK me përkrahje të DFID-it ka organizuar pesë punëtori në baza rajonale për të shqyrtuar sfidat dhe mundësitë e procesit të decentralizimit përmes pesë shërbimeve sociale: i) përkujdesja e të moshuarve në institucione, ii) dhuna në familje, iii) puna e fëmijëve, iv) adoptimi, dhe v) besimi i fëmijëve. Pesë Komisionet e AKK-së të formuara nga Kolegjiumi për Mirëqenie Sociale kanë qenë përgjegjëse për njërin nga këto shërbime sociale.

SHKURTIMISHT

AKK-ja ka marrë pjesë në Ceremoninë e nënshkrimit të granteve për Bashkëpunim Ndër-Komunal të ndara nga UNDP-ja e ku AKK ka qenë iniciator i këtij projekti.

Me është mbajtur takimi i Komisionit për Rini në kuadër të Kolegjiumit për Arsim, Kulturë e Rini i cili ka zhvilluar qëndrimin e komunave rreth krijimit të një kodi të veçantë buxhetor për rini.

AKK-ja ka pasur takim me përfaqësues të ICO-së për të diskutuar rreth ndryshimeve në ligjin për ndërmarrjet publike. AKK-ja kërkoi që komunave t'u lejohej të themelojnë ndërmarrje publike komunale për shërbime publike.

Kolegjiumi për Mirëqenie Sociale ka vizituar Shqipërinë për të mësuar nga përvojat e tyre dhe poashtu ka diskutuar për procesin e deritashëm të decentralizimit të shërbimeve sociale si dhe për hapat e ardhshëm.

AKK-ja kërkon plotësim-ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal

Me anë të një kërkesë nënshkruar nga kryetari z.Bajrush Xhemaili dhe drejtuar z.Bedri Hamza – Ministër i Ministrisë së Financave dhe z.Slobodan Petrovic – Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), kërkon fillimin e plotësim-ndryshimit të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049.

Në këtë letër thuhet se ndryshimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, duhet të bëhet për arsye : - të ndryshimit të procedurave të fillimit të biznesit – reformat që duhet të bëhet për “Të bërit biznes” në Kosovë, që ndikon në heqjen e pagesave në administratën komunale, me qëllim të lehtësimeve që duhet t'u bëhen qytetarëve që hapin biznese dhe - ndryshimi duhet të bëhet edhe për formulën e ndarjes së grantit buxhetor për komunat, pasi ka ndryshuar numri i banorëve pas regjistrimit të popullsisë në Kosovë.

Kolegjiumi për Arsim i AKK-së takohet me ministrin e MASHT-it

Kryesia e Kolegjiumit për Arsim u takua me ministrin e Arsimit z.Ramë Buja. Në këtë takim Kryesia e Kolegjiumit të Drejtorëve të Arsimit për të gjitha problemet, sfidat, vështirësitë dhe problemet e tyre i propozoi masat adekuate Ministrin të Arsimit, si dhe Institucioneve relevante.

REKOMANDIME:

- Nxjerrja e Udhëzimit Administrativ mbi ruajtjen e vendit të punës së drejtorit të shkollës;
- Nxjerrja e UA që shkollat fillore dhe të mesme të ulta të emërtohen “Shkolla nëntë vjecare” apo pesë vjecare (nëse është e ndarë) për shkak të titullit të gjatë.
- Zbatimi i UA për Vazhdimin e kontratës së punës për mësimdhënësit-puntorë pas 65 viteve brenda vitit mësimor. (ky Udhëzim ka qenë por nuk është harmonizuar me ligjin, mësimdhënësit të cilët kanë punuar deri në fund të viti shkollor nuk janë kompenzuar);
- Nxjerrja e UA për verifikimin e aftësive psiko-fizike të mësimdhënësve me sëmundje kronike, pensionimin e parakohshëm etj.
- Nxjerrja e UA që lejon përsëritjen e klasës edhe të nxënësve deri në klasën e VI-të, me qëllim që mos të humbet motivi i punës së nxënësve sepse atë që humbin nxënës deri në këtë moshë nuk mund të riparohen lehtë pas klasës së VI-të;
- Nxjerrja e UA mbi Normativin për ngarkesën e mësimdhënësve dhe numrin e orëve për mësim të rregullt deri në 24 orë si normë të përgjithshme (me formulë financimi);
- Nxjerrja e UA për futjen e orës së kujdestarisë në fund të orëve, me qëllim të evitimit të disa dukurive negative dhe përmirësimin e suksesit të nxënësve.
- Nxjerrja e UA që në lëndët e shkathtësisë mos t'i humbet viti nxënësit apo ato të jenë si lëndë fakultative.
- (Rregulloret Komunale, në harmonizim me ligjet në fuqi)
- Nxjerrja e UA që në vlerësimin e punës së mësimdhënësve të merren parasysh edhe rezultatet e punës me nxënës, si nga vlerësimi i brendshëm ashtu edhe i jashtëm. (Licensimi i mësimdhënësve për këtë ekziston UA 5/2010.)
- Nxjerrja e UA për masat stimuluese për nxënës dhe mësimdhënës për rezultate të dalluara në procesin mësimor. (Rregulloret Komunale për aktivitetet e nxënësve);
- Nxjerrja e UA për nostrifikimin e diplomave të mësimdhënësve (nostrifikimi bëhet vetëm për mësimdhënësit që e kryejnë jashtë shkollimin e lartë).

Delegacioni i Komunave të Kosovës mori pjesë në punimet e Kongresit të Pushteti Lokal dhe Regjional të Këshillit të Evropës

Me ftesë të Kongresit të Pushteti Lokal dhe Regjional të Këshillit të Evropës në Strasbourg / Francë, delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) o përbërë nga z.Bajrush Xhemaili, Kryetar i komunës së Ferizaj dhe i AKK-së, z.Pal Lekaj, kryetar i komunës së Gjakovës dhe anëtar i Bordit të AKK-së, z.Gradimir Mikic, kryetar i komunës së Ranillugut dhe anëtar i Këshillit të AKK-së si dhe Sazan Ibrahim, Drejtor Ekzekutiv i AKK-së kanë marrë pjesë në punimet e sesionit të 21-të të Kongresit, i cili u mbajtë prej 18-20 tetor 2011.

Diskutimet u përqendruan në temën 'Të jetojmë së bashku me dinjitet', involvimi i qytetarëve në vendim-marrje në nivelin lokal.



Anëtarët e Kongresit diskutuan edhe për situatën e komunitetit rom dhe rolin e Autoriteteve Lokale në promovimin e integritit të këtij komuniteti. Gjithashtu u paraqiten edhe disa raporte të vlerësimit të demokracisë lokale në disa shtete të Evropës. Raporti mbi zgjedhjet lokale në Shqipëri ishte një ndër pikat e diskutimit gjatë sesionit të 21 të kongresit të pushtetit lokal si dhe me rastin e Javës së Demokracisë Lokale në Evropë, pjesëmarrja qytetare ishte ndër temat kryesore për diskutim. Gjatë qëndrimit në Strasbourg delegacioni i AKK-së u prit nga Kryetari e Kongresit të Pushtetit Lokal të Këshillit të Evropës, z.Keith Whitmore. Me këtë rast Kryetari i AKK-së, z. Xhemaili e falenderoi z.Whitmore për kontributin e tij personal dhe të Këshillit të Evropës në përkrahjen e autoriteteve lokale në Kosovë rreth zhvillimit të demokracisë lokale. Gjithashtu, z.Xhemaili njoftoi kryetarin Ehitmore për të arriturat e autoriteteve lokale dhe sfidat e tyre në të ardhmen si dhe paraqiti të gjeturat nga Raporti i Progresit lidhur me pushtetin lokal në Kosovë të publikuara javën e kaluar nga Komisioni Evropian. Kryetari Xhemaili në emër të autoriteteve lokale të Kosovës kërkoi nga z. Whitmore që mundësisht Këshilli i Evropës të bëjë një analizë rreth zhvillimit të Demokracisë lokale në Kosovë. Kryetari i Kongresit të Pushteti Lokal, z.Keith Whitmore duke falenderuar delegacionin nga Kosova për pjesëmarrje në punimet e Kongresit të Pushtetit Lokal të Këshillit të Evropës çmoi lartë kontributin e Asociacionit të Komunave të Kosovës në zhvillimin e demokracisë lokale në Kosovë dhe vlerësoi lart kontributin e AKK-së në përkrahjen e komunave të reja të dala nga procesi i decentralizimit. Në vazhdim z.Whitmore theksoi që AKK-ja është një model i mirë për Asociacionet në rajon sa i përket punës, si dhe përfshirjen e të gjitha partive politike dhe komuniteteve të ndryshme në aktivitetet e saja. Në lidhje me mundësinë e zhvillimit të një raporti të vlerësimit mbi situatën e demokracisë lokale në Kosovë, z.Whitmore premtoi që këtë çështje do ta diskutojë në Byronë Ekzekutive të Këshillit të Evropës dhe më pas do t'i informojë organet e AKK-së.

SHKURTIMISHT

Janë organizuar pesë punëtori në nivel regjional për shërbimet sociale, ku kanë marrë pjesë Drejtorët komunal përgjegjës për Mirëqenie sociale, Drejtorët Komunal për Buxhet dhe Financa dhe zyrtarët tjerë komunal, pastaj Drejtorët e Qendrave për Punë Sociale dhe zyrtarë tjerë të këtyre Qendrave. Tema e punëtorive ka qenë decentralizimi i shërbimeve sociale, sfidat dhe mundësitë për zbatim të këtyre kompetencave.

Komisioni për Mirëqenie Sociale në kuadër të Kolegjiumit për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale i AKK-së është takuar për të diskutuar rezultatet e pesë punëtorive rajonale për decentralizimin e shërbimeve sociale.

Është mbajtur takimi i Kolegjiumit të Zyrtareve Ligjor për të debatuar të arriturat nga zbatimi i Ligjit për Partneritet Publiko-Privat, nevojat për trajnim për zyrtarët ligjor dhe çështjet aktuale nga fusha e legjislacionit.

SHKURTIMISHT

Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takimin e Grupit Punues për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Pyje.

AKK-ja është anëtar në grupin punues për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Bibliotekat në Kosovë, ku ka dhënë propozimet, të cilat u pranuan nga grupi punues, që secilës komunë t'i mundësohet themelimi i Bibliotekës Komunale, pasi që deri më tani në Kosovë kishte vetëm Biblioteka Ndërkomunale.

Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takimin e Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Planifikim Hapësinor dhe Zhvillim Rural ku u shqyrtua Projektligji për Mbeturinat.

Përfaqësuesi i AKK-së, mori pjesë në takimin e organizuar nga MAPL-ja "Grupi Punues për Reformën e Legjislacionit dhe Bartjen e Kompetencave" ku AKK-ja paraqiti shqetësimet e komunave për disa fusha, si të mirëqenies sociale, pylltarisë, shërbimeve-publike etj.

A po shkatërrohen pyjet?

Në seminarin e organizuar për të diskutuar për rolin e qeverisë qendrore dhe lokale për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve në Kosovë, Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së tha se "se prej kur është bërë delegimi i kompetencave është ndaluar në masë të madhe edhe prerja e pyjeve në mënyrë ilegale, mirëpo numri i punëtorëve në sektorin pyjor nuk është i mjaftueshëm për kryerjen me sukses të përgjegjësive të deleguara".



Në këtë seminar të organizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Organizata Holandeze për Zhvillim (SNV) Ministri i Bujqësisë, Blerand Stavileci, tha se menaxhimi i mirë i pyjeve nënkupton ruajtjen dhe përdorimin e pyjeve në përputhje të plotë me kapacitetin regjenerues dhe potencialin për të përmbushur funksionet shumëdimensionale të tyre. "Në vitin e kaluar ne e kemi filluar delegimin e kompetencave nga niveli qendror në nivelin lokal për menaxhimin e pyjeve dhe pas kësaj periudhe njëvjeçare, përkundër punës që është bërë, fenomenet negative si prerja ilegale e drunjve janë ende në përmasa tejet shqetësuese", tha ministri Stavileci. Në këtë diskutim publik, përfaqësuesit e Asociacionit të Komunave të Kosovës thanë se prej kur është bërë delegimi i kompetencave është ndaluar në masë të madhe edhe prerja e pyjeve në mënyrë ilegale, mirëpo numri i punëtorëve në sektorin pyjor nuk është i mjaftueshëm për kryerjen me sukses të përgjegjësive të deleguara. Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së tha se të gjitha vërejtjet që janë dhënë nga krerët komunalë janë marrë për konsideratë nga ministria dhe ju është premtuar se ato do t'i inkoorporojnë në ligjin e ri për pyje. Vlen të ceket se, ligji i ri për pyjet do të miratohet gjatë muajve në vijim.



FOTOLAJM

Nga fjala e kryetarit të AKK-së mbajtur në Konferencën e Dytë Vjetore Ndërkombëtare për Qeverisjen Lokale

Takimi i Kolegjiut për Buxhet dhe Financa

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takimin e radhës së Kolegjiut për Buxhet dhe Financa, kryesuar nga Kryesuesja znj. Afërdita Grapci dhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z. Sazan Ibrahim, mbajtur prej 26 deri 28 Tetor 2011 në Tiranë/Shqipëri. Në këtë takim morën pjesë Drejtorët për Buxhet dhe Financa nga Komunitat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Rahovec, Ranilluk, Novobërdë, Gjilan, Junik, Pejë, Kaçanik, Shtërpçë, Hani i Elezit, Prizren, Klinë, Istog, Mamushë, Drenas, Skenderaj, Mitrovicë, Gjakovë, Shtime, Ferizaj, Junik dhe Podujevë. Po ashtu të ftuar ishin tre Ministrinë relevante: MPMS – z. Mentor Morina, MAPL - z. Avni Sahiti, dhe MF - z. Petrit Popova i cili nuk mori pjesë në takim. Në këtë takim ishte prezent edhe Kryesuesi i Kolegjiut për Mirëqenie Sociale z. Bashkim Hyseni, përfaqësuesit nga projekti i DIFID-it dhe stafi i AKK-së.



Qëllimi i takimit ishte diskutim në bazë të rendit të ditës me këto pika: roli i Ministrive relevante dhe perspektiva e tyre në procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale, çështjet e arritura nga Kolegjiut për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për decentralizimin e shërbimeve sociale, opsionet buxhetore dhe shërbimet sociale, kosto e njësisë dhe Skenari për shërbimet sociale, Zhvillimi i Kapaciteteve dhe nevojave individuale të Kolegjiut për Buxhet dhe Financa për të mbështetur decentralizimin e shërbimeve sociale dhe Kolegjiut të SHMS-së për ushtrimin e kompetencave në fushën e shërbimeve sociale.

Rekomandimet dhe Konkluzionet

1. Komunitat të përcjellin në AKK të dhënat për të hyrat vetanake për vitet 2009-2011, me qëllim të paraqitjes së tyre para Fondit Monetar Ndërkombëtar
2. QPS-të të gjenerojnë të hyra nga shërbimet administrative (p.sh. heqja e nënshtetësisë) dhe të kenë petty cash për nevojat të përditshme;
3. Decentralizim i plotë i kompetencave në nivel lokal, përfshi edhe pagesën e beneficioneve në kesh;
4. Të ndryshohen kriteret e asistencës sociale (të mos ndërpritet asistenca pasi që fëmijë mbush 5 vjet);
5. Krijimi i një komunikimi të ri mes institucioneve relevante në mënyrë që të precizohet përgjegjësia dhe llogaridhënia;
6. Shqyrtimi i mundësive për kompletim të stafit profesional në QPS (psikolog, pedagog, etj). Për shkak të kufizimeve të punësimit të stafit të ri, të shqyrtohet mundësia që të bëhet rotacioni i stafit;
7. Trajnimi i zyrtarëve të QPS-ve (Drejtori dhe stafi tjetër) dhe komunitat (Drejtori i SHMS dhe stafi tjetër). Pozita e Shefit të Sektorit të Mirëqenies sociale në komunitat të fuqizohet në veçanti. Në këtë aspekt komunitat mund të zhvillojnë kapacitetet e tyre duke u bazuar në përvojën dhe ekspertizën e stafit të QPS-ve;
8. Trajnim për Drejtorët për buxhet dhe financa në instrumentet e reja për financim të shërbimeve sociale;
9. Informimi i Kryetarëve të komunitat rreth shërbimeve sociale.

SHKURTIMISHT

AKK-ja mori pjesë në Këshillin Drejtues të Projektit të Zyrës Ndërlidhëse të BE-së, për Sistemin e Unifikuar të Adresave, ku pritet fillojë pilot projekti në Komunitat e Prizrenit.

AKK-ja mbajti takim me Zyrtarët e Projektit të Binjakëzimit që ndihmojnë pushtetin lokal për të diskutuar Ligjin për Ndërmarrje Publike e të cilëve iu paraqiten edhe rekomandimet e AKK-së.

Bordi i AKK-së mbajti takim me Ministrin e Ministrisë për Zhvillim Ekonomik dhe stafin e tij ku temë e diskutimit ishte Ligji për Ndërmarrjet Publike, i cili është në procedurë të amendamentimit.

Është mbajtur takimi i Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor ku diskutoi për: Zbatimin e Ligjit për Shfrytëzimin e Pronës Komunitat, Zbatimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Zbatimin e Ligjit për Pyjet.

SHKURTIMISHT

AKK-ja ishte anëtar në Grupin Punues për hartimin e tetë (8) Udhëzimeve Administrative për zbatimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e e Paluajtshme, të cilat Udhëzime janë nënshkruar dhe të publikuara u janë shpërndarë të gjitha komunave.

AKK-ja mori pjesë në punëtoritë që i organizoi projekti i BE-së për binjakëzim që po e mbështet Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për definimin e kompetencave mes Departamentit për Pylltari në kuadër të MBPZHR, Agjencionit për Pyje dhe Komunave.

AKK-ja kërkoi nga Ministri i Ministrisë së Financave dhe Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal fillimin e plotësim-ndryshimit të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal N3.03/L-049, për arsye të ndryshimeve që kanë sjellë ligjet tjera e që po afektojnë këtë ligj.

Takimi i Këshillit të Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës

25 tetor 2011 - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takimin e Këshillit të Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës me përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Agjencionit për Ushqim dhe Veterinë dhe ICITAP-t. Me qëllim të zbatimit sa më të mirë në praktikë të ligjeve që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e autoriteteve lokale u organizua ky takim, ku për diskutim kishte disa pika ndër to, Ligji për Ndërmarrje Publike, Inspeksioni sanitar dhe fito-sanitar dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSB).

Në këtë takim morën pjesë kryetarët e komunave, zv.Ministri i Ministrisë për Zhvillim Ekonomik z.Ramadan Hasani, Udhëheqësi i Njësisë për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në MZHE z.Ramadan Sejdiu, Kryeshefi i Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë z.Valdet Gjinovci, zv.drejtori i programit ndërkombëtar për trajnim të hetuesisë kriminale (ICITAP) z.Kamerun Fisher si dhe zyrtarët nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK). Ky takim u kryesua nga Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahimimi.

z.Agim Veliu-anëtar i Bordit të AKK-së dhe kryetar i Komunës së Podujevës- AKK-ja gjatë aktiviteteve të deritanishme shumë herë ka shprehur brengën e komunave të Republikës së Kosovës rreth menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike, e në disa raste lirisht mund të them që ka qenë i vetmi mekanizëm i cili ka ngritur këto shqetësime, e të cilat shqetësime disa herë iu janë paraqitur edhe më shkrim autoriteteve qëndrore të Republikës së Kosovës. Justifikimi i këtyre vërejtjeve është bërë nga krerët komunal të cilët ballafaqohen me këto probleme në punën e tyre të ditë përditshme. Ne konsiderojmë që disa procese që kanë sjellur komunat e Kosovës para një akti të kryer, si proseci i regjionalizimit dhe korporatizimit, nuk kanë gjetur përkrahje nga autoritetet lokale. Sa i përket menaxhimit të ndërmarrjeve publike që merren me ofrimin e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave lirisht mund të them që ligji i tanishëm mbi Ndërmarrjet Publike bie ndesh me parimet që burojnë nga Karta Evropiane mbi Vetë-Qeverisje Lokale si dhe me LVL-në.

Diskutimet e kryetarëve:

z.Qemajl Mustafa- Kryetar i Komunës së Gjilanit –Komunat duhe të jenë të përfshira në Borde- në bazë të përqindjes së aseteve, pastaj duhet të gjendet një formulë e përfaqësimit.

z.Isa Mustafa – Kryetar i Komunës së Prishtinës –Ilustrimi i këtij ligji nuk zgjidh problem, kemi komisionin e aksionerëve, bordit e drejtorëve, drejtorin menaxhues, kemi përzjerje të kompetencave. Çështja e dytë është prona, nëse një NP është lokale, pasuria është e Komunës, asetet e komunës kur të shitet mjetet duhet i takojnë komunës. Por cka ndodh kur një ndërmarrje kryen shërbim për disa komuna, konsiderohet NP regjionale, regjionalizimi nuk është i përcaktuar në Kushtetutë.

z.Nexhat Demaku – Kryetar i Komunës së Drenasit –Unë pyes pse nuk po ecin kërkesat e qytetarëve, kanë kaluar të gjitha limitet, këto kërkesa kanë ardhur si rezultat i nevojave, mendoj se legjislati duhet t'i përshtatet zhvillimit ekonomik.

z.Shaip Surdulli – Kryetar i Komunës së Kamenicës – Jam i pakënaqur me punën e grupit ndërmintor, janë marrë parasysh vetëm raportimet nga menaxhmenti i NP-ve e jo edhe kërkesat e kryetarëve të komunave. Ne jemi në gjendje të themelojmë NP lokale.

z.Pal Lekaj – Kryetar i Komunës së Gjakovës – A po përgatisim ligj për qytetarët apo për qeveritarët. Ky ligj fare nuk ka ndryshuar, nuk ka pas nevojë për plotësim-ndryshim, nëse nuk merren paraqysh komentet e AKK-së. Ne jemi nisur prej LVL-së, ligjit bazë të komunave, që plotësimet e LNP të bëhen konform këtij ligji bazë. Në fokus janë qytetarët dhe shërbimet për ta, ndërsa juve të qeverisë, iu themi "rruga e mbarë pa kryetar dhe pa qytetarë".

z.Agim Haziri – Kryesues i Kolegjiumit të Shërbimeve Publike të AKK-së – Ky ligj ka të bëjë me elementet jetike. Decentralizimi është kuptuar vetëm për themelimin e komunave të reja, ndërsa në ofrimin e shërbimeve publike nuk po ndodh ky decentralizim.

z.Ramadan Muja – Kryetar i Komunës së Prizrenit – Gati të gjitha kompetencat i janë marrë komunave, neve na kanë mbetur vetëm katër inspektorate, gradualisht të gjitha kompetencat po centralizohen.

Disa nga rekomandimet kryesore të cilat AKK-ja i ka paraqitur edhe në të kaluarën rreth çështjes së Ndërmarrjeve Publike janë:

1. Nuk është e drejtë që komuna nga të hyrat vetanake të investojë në rrjetin e kanalizimit, ujësjellësit etj., kurse pastaj këto investime dhe asete t'i barten Ndërmarrjeve Publike dhe që këto shërbime të menaxhohen nga Qeveria Qendrore kurse komunat të mos jenë të përfaqësuar në mekanizmat vendim-marrës të këtyre ndërmarrjeve;
 2. Krerët komunal e kanë të qartë që uji është resurs natyror dhe që me këto resurse duhet të menaxhojë Nivelin qendror mirëpo patjetër se komuna duhet të ketë rol vendimtar në menaxhimin e kompanive të cilat ofrojnë shërbime ndaj qytetarëve;
 3. Sa i përket menaxhimit të mbeturinave, Komunat duhet ti marrin përsipër përgjegjësitë e tyre të plota në pajtim me Draft Ligjin mbi Mbeturinat, ku përfshihen: licencimi, përcaktimi dhe mbledhja e taksave, vetëdijësimi publik, monitorimi i performancës së shërbimit dhe zgjidhja e ankesave. Të gjitha këto aktivitete duhet të jenë përgjegjësi e secilës Komunë. Shpresojmë thellë që ky ligj do të aprovohet nga Kuvendi i Kosovës këtë vit;
 4. Sektori privat duhet të përfshihet në procesin e ofrimit të shërbimeve në grumbullimin e mbeturinave Komunale, përmes tenderimit të shërbimeve në grumbullimin kudo që vendos Komuna;
 5. Të krijohen kapacitetet dhe mekanizmat e nevojshëm për zbatimin e legjislacionit dhe implementimin e politikave;
 6. Komunave t'iu mundësohet themelimi i NP lokale për ofrim të shërbimeve sa më afër qytetarit;
 7. Stacionet e autobusëve duhet të menaxhohen nga komunat se një praktikë e tillë është treguar më efikase dhe që një praktikë e tillë është duke u zbatuar edhe në shtetet në rajon;
- Në këtë takim kanë diskutuar edhe: z.Ramadan Hasani- zv.Minister MZHE, z.Agron Maxhuni- Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL, z.Ramadan Sejdiu- Udhëheqës i Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në MZHE, z.Sherif Bilalli – përfaqësues nga Komuna e Vushtrisë, z.Naser Gjinovci – Kryeshef i Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), z.Kamerun Fisher nga ICITAP-i etj.

SHKURTIMISHT

AKK-ja po merr pjesë në Grupin Punues për shqyrtimin e draft Ligjit për Parkun Kombëtar "Sharri " (i cili përfshin pesë komuna Kaçanik, Shtërpcë, Suharekë, Prizren dhe Dragash) dhe Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", (i cili përfshin pesë komuna Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog).

AKK-ja është anëtar në Grupin Punues për Projektligjin për Pyje, dhe ka arritur që kërkesat e anëtarëve të Kolegjiumeve në fushën e mbrojtjes të rregullohen me ligj dhe të hyrat nga pylltaria, 50 % të kthehen në buxhetet komunale.

Në Kuvendin e Kosovës, ka kaluar leximin e parë Ligji për Mbeturinat, dhe pritet shpejt miratimi i tij e ku me këtë ligj komunat do t'i kenë kompetencat të menaxhojnë, themelojnë dhe kontrakttojnë ndërmarrje për mbeturina. AKK-ja ishte anëtar në Grup Punues, dhe nga 21 rekomandimet e AKK-së, 17 janë pranuar dhe janë vendosur në ligj.

Mbahen pesë punëtori rajonale për shërbime sociale

AKK me përkrahje të DFID-it ka organizuar pesë punëtori në baza rajonale për të shqyrtuar sfidat dhe mundësitë e procesit të decentralizimit përmes pesë shërbimeve sociale: i) përkujdesja e të moshuarve në institucione, ii) dhuna në familje, iii) puna e fëmijëve, iv) adoptimi, dhe v) besimi i fëmijëve. Pesë Komisionet e AKK-së të formuara nga Kolegjiumi për Mirëqenie Sociale kanë qenë përgjegjëse për njërin nga këto shërbime sociale.

Kjo ishte hera e parë që organizohen takime të formatit të tillë pas decentralizimit të shërbimeve sociale në vitin 2009. Kjo iniciativë është mirëpritur nga shumica e pjesëmarrësve dhe është kërkuar që ky komunikim të vazhdojë edhe më tutje. Punëtoritë janë udhëhequr nga Drejtorët komunal përgjegjës për mirëqenie sociale (DMS) në bashkëpunim me AKK. Përfaqësuesit e Qendrave për Punë Sociale (QPS) të përfshirë në Komisionet e AKK-së kanë prezantuar për fushat e caktuara. Në çdo punëtori kanë marrë pjesë më shumë se 20 pjesëmarrës, përfshirë përfaqësuesit komunal përgjegjës për mirëqenie sociale dhe buxhet dhe financa, si dhe përfaqësues të QPS-ve përgjegjës për shërbime sociale dhe financa. Sidoqoftë jo të gjithë DMS-të kanë marrë pjesë. Përfaqësuesit e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS) kanë qenë prezent në çdo takim dhe kanë prezantuar për fushat e caktuara. Përfaqësuesit e Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal (MAPL) kanë qenë prezent vetëm në takimin e parë, ndërsa përfaqësuesit e Ministrisë së Financave (MF) nuk iu janë përgjigjur fare ftesës së AKK-së. Në çdo punëtori është prezantuar projekti i DFID-it dhe, në mes tjerash, mbështetja që i ofrohet Komunave dhe AKK-së.

KONKLuzionet dhe Rekomandimet e Punëtorive

1. Kërkohet një vendim i prerë së çka duhet decentralizuar ose centralizuar. Komunat kërkojnë që të marrin kompetencat e plota politike, financiare dhe administrative për shërbime sociale, në të kundërtën të gjitha kompetencat duhet kthyer në nivel qendror.

Buxhet

1. QPS-të kanë nevojë për një rregullore për përcaktimin e rregullave rreth kompensimit për punë shtesë (jashtë orarit, kujdestari, puna natën, etj), rrezikshmëri dhe unifikimin e koeficienteve. Kjo rregullore duhet përpiluar nga komunat dhe mundësisht të miratohet nga Kuvendët Komunale.

2. Komunat duhet të përfshijnë QPS-të në procesin e buxhetimit për të arsyetuar kërkesat buxhetore para Kuvendëve Komunale. Përveç tjerash, QPS-të kanë nevojë për staf profesional si pedagog, psikolog, punëtor social, sociolog, etj për të profilizuar punën e punëtorëve social. MPMS duhet të bëjë trysni mbi MF për të siguruar mjetet e nevojshme për

zbatimin e standarde, përndryshe nuk mund të kërkojnë përgjegjësi nga komunat në rast të lëshimeve për arsye të mungesës së buxhetit.

3. Komunat duhet mundësuar që QPS-të të menaxhojnë me petty cash-in për raste emergjente.

4. QPS-të mund të gjenerojnë të hyra nga shërbimet si lëshimi i certifikatave për heqje dorë nga nënshtetësia, përfaqësim në gjykata, etj. Komunat mund të shqyrtojnë një mundësi të tillë në kuadër të procedurave lokale legjislative.

Marrëdhëniet ndër-institucionale

1. Procesi i bartjes së kompetencave kërkon angazhim të të gjitha institucioneve relevante. Mungesa e disa DMS-ve, MAPL-së dhe MF-së paraqet një shqetësim serioz në këtë aspekt.

2. Duhet zhvilluar mekanizma që do të institucionalizojnë një komunikim dhe bashkëpunim më të thellë mes QPS-ve, komunave dhe ministrive përkatëse. Megjithatë, ruajtja e konfidencialitetit është kyçe në këtë proces.

3. QPS-të kanë nevojë për një Statut i cili do të përcaktonte qartë rolin dhe përgjegjësitë e tyre. Kolegjiumi/Komisionet mund të hartonin një model Statut të cilin çdo Kuvend Komunal do ta miratonte sipas specifikave të veta.

4. Kolegjiumi së bashku me MPMS dhe në konsultim me QPS-të mund të hartoj një format të raportimit i cili do të lehtësonte raportimin e QPS-ve dhe do të qartësonte drejtë se çfarë informata duhet të kenë komunat dhe çfarë MPMS. Në këtë kontekst duhet vendosur se a duhet apo jo komunat të kenë qasje në databazë dhe në çfarë niveli.

5. Kërkesa e përgjithshme është që mirëqenia sociale të ndahet nga Drejtoria e shëndetësisë. Nëse kjo nuk mund të bëhet për shkaqe buxhetore (sidomos në komunat më të vogla), atëherë komunat së paku mund të fuqizojnë rolin e Shefit të sektorit për mirëqenie sociale.

6. Për shkak të rëndësisë së bashkëpunimit ndër-institucional, në të ardhmen duhet ftuar të gjithë akterë të përfshirë në shërbime sociale, si p.sh. gjykata, policia, OJQ-të, etj.

7. Komunat mund të shqyrtojnë mundësinë që vet apo në bashkëpunim me komunat tjera të blejnë shërbime nga OJQ-të, si p.sh. në fushën e përkujdesjes së të moshuarve apo edhe raste tjera.

Zhvillimi i kapaciteteve

1. Përveç plotësimit të stafit me pedagog, psikolog, etj, punëtorët social kanë nevojë për trajnime shtesë në ngritjen e profesionalizmit gjatë ofrimit të shërbimeve sociale. Lloji dhe natyra e trajnimeve mbetet të identifikohet.

2. Staf komunal ka nevojë për trajnime rreth shërbimeve sociale. Lloji dhe natyra e trajnimeve mbetet të identifikohet.

3. Duhet të ketë program të veçantë për vetëdijësimin e Kryetarëve të komunave për punët e QPS-ve.

4. Puna e Komisioneve të AKK-së për shërbime sociale në të ardhmen duhet specifikuar.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS BULETINI

Viti VIII, Nr. 50 • Shtator - Tetor 2011

PËRGATITI:

Arsim Osmani - MENAXHER PËR KOMUNIKIM

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

